

RAPORT

MONITORIMI I SHPENZIMEVE
TË SEKTORIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
PËR VITIN 2022



Monitorimi i shpenzimeve të sektorit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitin 2022

MAJ 2023



Tabela e përmbajtjes

HYRJE	5
Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një krahasim në vite	6
Monitorimi i Buxhetit të MSHMS sipas programeve buxhetore	11
Programi “ <i>Planifikim, Menaxhim dhe Administrim</i> ”	11
Programi “ <i>Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor</i> ”	13
Programi “ <i>Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor</i> ”	16
Programi “ <i>Shërbime të Shëndetit Publik</i> ”	22
Programi “ <i>Shërbime Kombëtar i Urgjencës Mjekësore</i> ”	25
Programi “ <i>Përkujdesi Social</i> ”	26
Programi “ <i>Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë</i> ”	29
Konkluzione	32



Grafikë

Grafiku 1. Devijanca e shpenzimeve për programet kryesore të MSHMS

Grafiku 2. Plani i rishikuar MSHMS 2022

Grafiku 3. Fakti MSHMS 2022

Grafiku 4: Shpenzimet faktike në vite në % ndaj Buxhetit faktit të MSHMS

Grafiku 5: Shpenzimet e shëndetësisë ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike për vendet e rajonit

Tabela

Tabela 1: Programi “Planifikim Menaxhim dhe Administrim”

Tabela 2: Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”

Tabela 3: Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”

Tabela 4: Programi “Shërbime të Shëndetit Publik”

Tabela 5: Programi “Shërbime Kombëtar i Urgjencës Mjekësore”

Tabela 6: Programi “Përkujdesi Social”

Tabela 7: Programi “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë”



HYRJE

Ky raport synon të paraqesë një pamje të përgjithshme të shpenzimeve publike të bëra në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale gjatë vitit 2022. Ai analizon shpenzimet e kryera (faktike) për vitin 2022 sipas zërave të shpenzimeve dhe produkteve/projekteve të investimeve publike, krahasuar me planifikimin fillestar dhe atë të rishikuar të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Raporti synon të analizojë devijancat nga plani dhe arsyet e tyre për çdo program buxhetor nën administrimin e kësaj Ministrie. Meqenëse Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale menaxhon dy fusha të rëndësishme të politikave, konkretisht fushën e shëndetësisë dhe fushën e mbrojtjes sociale, një fokus i veçantë në këtë raport do t'i kushtohet dhe analizës së këtyre fushave më vetë në terma financiare dhe terma përfituesish.

Të dhënat dhe kufizimet

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë marrë nga faqja zyrtare e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe nga faqja zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për shkak se ende nuk është finalizuar dhe publikuar buxheti faktik për vitin 2022 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për disa tregues makroekonomikë, sikurse është Produkti i Brendshëm Bruto dhe shpenzimet e përgjithshme publike, të dhënat e marra nuk përbëjnë shifrat finale faktike por projeksione të pritshme të publikuara nga MFE. Të dhënat e publikuara nga MSHMS dhe MFE mbi monitorimin e buxhetit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezultojnë të kufizuara, duke vështirësuar analizën e performancës së shpenzimeve dhe produkteve të realizuara në këtë sektor gjatë vitit 2022.

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një krahasim në vite

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2022 në total, sipas planit fillestar, planit me ndryshime¹ dhe faktit në nivel programi buxhetor, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti i MSHMS sipas programeve buxhetore	Shpenzime Faktike 2021	Plani Fillestar Vjetor 2022	Plani Vjetor i Rishikuar 2022	Devijanca e planit gjatë vitit	Shpenzime Faktike 2022	Devijanca e planit ndaj faktit	Realizimi i Buxhetit të MSHMS në %
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,534,148.00	380,200.00	452,668.00	72,468.00	446,243.51	6,424.49	99
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	945,121.17	1,035,991.00	1,031,755.00	-4,236.00	1,027,241.16	4,513.84	100
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,421,690.04	8,805,125.00	7,526,671.00	-1,278,454.00	7,696,366.70	-169,695.70	102
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	31,938,573.08	33,342,128.00	33,654,000.50	311,872.50	33,465,294.74	188,705.76	99
Shërbime të Shëndetit Publik	7,016,121.42	6,360,146.00	4,954,714.00	-1,405,432.00	4,869,955.08	84,758.92	98
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	289,775.06	334,162.00	241,695.00	-92,467.00	232,994.82	8,700.18	96
Përkujdesja Sociale	28,215,775.26	26,818,130.00	29,690,471.00	2,872,341.00	29,493,996.32	196,474.68	99
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë	78,361,204.02	77,075,882.00	77,551,974.50	476,092.50	77,232,092.32	319,882.18	100

*Tejkalimi i shpenzimeve faktike për programin “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” ndodh për shkak se në shpenzimet faktike të programit janë përfshirë dhe dy projekte investimi me financim të huaj për të cilët nuk është planifikuar plan buxheti për vitin 2022.


Sikurse shihet nga tabela, buxheti fillestar i alokuar për vitin 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është në masën 77.075 miliardë lekë. Peshën më të lartë të buxhetit e kanë 3 programe buxhetore, konkretisht programi “Shërbimet të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” dhe programi “Përkujdesja Sociale”.

Plani i rishikuar buxhetor gjatë vitit 2022 rezulton në masën 77.55 miliardë lekë ose gati **476.09 milionë lekë më shumë krahasuar me buxhetin fillestar**. Devijancat më larta të planit buxhetor krahasuar me alokimet fillestare rezultojnë me pakësimin në masën 1.4 miliardë lekë në programin buxhetor “**Shërbimet të Shëndetit Publik**” dhe pakësim në masën 1.2 miliardë lekë në programin buxhetor “**Shërbime të Kujdesit Parësor**”. Ndërkohë, është shtuar me 2.8 miliardë lekë programi buxhetor “**Përkujdesja Sociale**”, duke rezultuar në një zhvendosje të burimeve financiare nga politikat shëndetësore në ato të mbrojtjes sociale, fokus i cili erdhi si rezultat i politikave të

¹ Plani me ndryshime paraqet ndryshimet që pëson buxheti fillestar i akorduar gjatë vitit 2022 si rezultat i akteve normative dhe të gjitha rialokimeve buxhetore të ndodhura gjatë vitit. Në këtë plan përfshihen dhe shtesat që i bëhen buxhetit të shtetit me Vendime të Këshillit të Ministrave nga Fonde të pashpërndara buxhetore sikurse është Fondi Rezervë.


qeverisë për të mbështetur shtresat sociale në nevojë me **dy paketa të rezistencë sociale** me synim zbutjen e efekteve të lëna në ekonomi nga lufta Rusi-Ukrainë.

Devijanca e shpenzimeve për programet kryesore të MSHMS




Sa i përket devijancave të planit të rishikuar me faktin, ato rezultojnë të vogla me gati 319.8 milionë lekë ose 0.4% e totalit të buxhetit të rishikuar. Në total buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezulton i realizuar me 99.6%, krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2022. Konkludojmë që devijanca më të larta paraqet planifikimi i fondeve buxhetore, pasi sikurse shihet ka lëvizje **të mëdha të planit fillestar me atë të rishikuar gjatë vitit, gjë e cila dëshmon inkosistencë në planifikim duke riskuar kredibilitetin buxhetor**. Nëse analizojmë shpenzimet për MSHMS sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve, do të shohim shpërndarjen sipas grafikut të më poshtë:

Plani i rishikuar MSHMS 2022



Fakti MSHMS 2022



Ndërkohë, nëse do të analizojmë historikun e shpenzimeve buxhetore faktike në vite për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vërejmë se buxheti i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerë nominale ka ardhur në rritje nga viti 2017 deri në vitin 2022.

Buxheti i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në përqindje ndaj PBB rezulton në rënie në vitin 2022 krahasuar kjo me dy vite më parë, rënie kjo pjesërisht e shpjegueshme prej faktit që në vitet 2020-2021 buxheti për sektorin e shëndetësisë pësoi rritje më të madhe se normalisht për të financuar shpenzimet e lidhura me menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga virusi i SARS COV-2 (COVID-19). **Sa i përket buxhetit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në raport me shpenzimet e përgjithshme publike**, ruhet një nivel mesatar prej 12.5%. Ajo që bie në sy është fakti që në vitin 2022 shpenzimet faktike të MSHMS shkojnë në nivelin 12%, në të njëjtin nivel si në vitin 2017, pavarësisht rritjes në vlerë nominale të trendit të shpenzimeve.

Në milionë lekë

<i>Buxheti i MSHMS</i>	2017	2018	2019	2020	2021	2022
<i>Fakti</i>	55,395	57,958	61,173	67,812	78,360	77,224
<i>Ne % ndaj PBB</i>	3.6%	3.5%	3.6%	4.1%	4.1%	3.8%
<i>Ne % ndaj Shpenzimeve të Përgjithshme Publike</i>	12.0%	12.2%	12.4%	12.6%	13.2%	12.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nëse do të analizojmë vetëm sektorin e shëndetësisë², shpenzimet në përqindje ndaj PBB në vite luhaten në intervalin 2.9%-3.4%, me një mesatare prej 3.1% të PBB. Ndërkohë, shpenzimet e shëndetësisë ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike përgjatë periudhës 2017-2022 rezultojnë në masën 10.1%. Në këtë mesatare është përfshirë viti 2021 i cili rezulton me shpenzime të larta (one off) për shkak të menaxhimit të situatës pandemike të shkaktuar në vend nga virusi SARS COV 2.


Në milionë lekë

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Shpenzimet funksionale shëndetësi	45,352	49,004	51,182	51,590	63,620	65,501
Shpenzimet e shëndetësisë ndaj PBB	2.9%	3.0%	3.0%	3.1%	3.4%	3.2%
Shpenzimet e shëndetësisë ndaj SHPP	9.8%	10.3%	10.4%	9.6%	10.7%	10.2%
PBB nominale	<i>1,550,645</i>	<i>1,636,730</i>	<i>1,691,903</i>	<i>1,644,077</i>	<i>1,889,839</i>	<i>2,058,155</i>
Shpenzimet e përgjithshme publike	<i>461,410</i>	<i>476,147</i>	<i>491,897</i>	<i>536,279</i>	<i>595,115</i>	<i>645,307</i>

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Shpenzimet faktike në vite sipas programeve kryesore buxhetore të MSHMS paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Ajo që vihet re është trendi në rënie i shpenzimeve për kujdesin parësor, kombinuar me trendin në rritje të shpenzimeve për shëndetin publik dhe atë dytësor. Sa i përket shpenzimeve të lidhura me mbrojtjen sociale, konstatohet që ruhet një trend normal përgjatë kësaj kohe, me mesatarisht 38.1% të buxhetit total të MSHMS.

Shpenzimet faktike në vite në % ndaj Buxhetit faktit të MSHMS



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale


² Sektori i shëndetësisë përfshin shpenzimet vetëm për fushën e shëndetësisë përfshirë dhe të ardhurat e siguruar nga pagesa e sigurimeve shëndetësore FDSKSH



Krahasuar me Rajonin, shpenzimet në sektorin e shëndetësisë për Shqipërinë në raport me shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë më të ulëtat, me mesatarisht 9.8% përgjatë periudhës 2015-2020, ndërkohë që kryeson listën e vendeve të rajonit me shpenzimet më të larta për shëndetësinë Bosnje-Hercegovina dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet e shëndetësisë ndaj Shpenzimeve të Përgjithme Publike për vendet e rajonit						
Vitet	2020	2019	2018	2017	2016	2015
Bosnja dhe Hercegovina	14.87	15.37	15.14	15.47	15.63	14.98
Republika e Maqedonisë së Veriut	12.83	13.56	12.41	11.83	13.05	12.78
Mali i Zi	13.13	11.52	10.53	9.73	10.92	11.63
Serbia	11	12.03	12.45	11.79	11.65	11.92
Shqipëria	9.6	10.4	10.3	9.8	9.62	8.88

Burimi: WHO database dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Burimi: WHO database dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Monitorimi i Buxhetit të MSHMS sipas programeve buxhetore

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2022 administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, si vijon:

- Planifikim Menaxhim Administrimi
- Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
- Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
- Shërbime të Shëndetit Publik
- Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
- Përkujdesi Social
- Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program harton dhe monitoron politika kombëtare, ndërsektoriale në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Qëllim i Politikës së këtij programi është “Sigurimi i një kujdesi shëndetësor dhe mbrojtjes sociale sipas standardeve të BE”. Realizimi i këtij qëllimi do të përmbushet përmes objektivit kryesor, konkretisht:

1. Sigurimi i standardeve të kujdesit shëndetësor përmes hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e kujdesit shëndetësor;

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programi "Planifikim Menaxhim dhe Administrim" 01110		Plani Fillestar Vjetor Viti 2022	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2022	Ndryshim i i planit vjetor	Në 000/lekë		
					Shpenzime Faktike të Periudhës/Pro gresive	Diferenca Plan-Fakt	Realizimi ne %
600	Paga	156,100	135,297	-20,803	135,282.08	15	100
601	Sigurime Shoqërore	26,067	22,615	-3,452	22,086.82	528	98
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	180,833	275,667	94,834	275,772.11	-105	100
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0.00	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	14,200	13,500	-700	7,576.44	5,924	56
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	2,589	2,589	2,526.47	63	98
Nëntotali Shpenzime Korente		377,200	449,668	72,468	443,243.91	6,424	99
230	Kapitale të Patruëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	3,000	3,000	0	2,999.60	0	100
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		3,000	3,000	0	2,999.60	0	100
Totali i Shpenzimeve Kapitale		3,000	3,000	0	2,999.60	0	100
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		380,200	452,668	72,468	446,243.51	6,424	99

Në këtë program konstatohet një rishikim në rritje i planit të buxhetit krahasuar me fillestarin për pjesën e shpenzimeve korrent në masën 72.4 milionë lekë. Në raportet zyrtare të publikuara nga MSHMS mungon një analizë e detajuar e arsyes së rritjes së buxhetit për të analizuar më tej dhe përdorimin e fondit buxhetor të rishikuar për program.

Referuar krahasimit të planit të rishikuar me faktin rezulton që realizimi i programit për **shpenzimet korrent dhe për shpenzimet kapitale rezulton në masën 99%. Programi paraqitet i qëndrueshëm** në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre. Produktet e programit janë të qëndrueshme që do të thotë janë përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore.

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Kodi i Produktit	Emertesa	Sasia Fillestare	Plani Fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzimet faktike
91301AA	Akte ligjore e nënligjore të miratuara	50	377,200	50	449,415	46	442,991
91301AB	Materiale mbrojtëse të blera për COVID-19	0	0	0	253	0	253
M133696	Kosto Lokale për PIU-n (njesia e zbatimit të projekteve të huaja)	1	3,000	1	3,000	3	3,000

Produkti “Akte Ligjore dhe nënligjore të miratuara” përbën produktin kryesor të këtij programi në të cilin janë shpenzuar të gjitha fondet e alokuara për shpenzimet korrente. Në terma sasior ishin planifikuar 50 akte të reja për t’u përgatitur nga stafi i këtij programi dhe janë realizuar 46 prej tyre ose 92% e planit.

Konstatohet që për vitin 2022 janë alokuar rreth 253 mijë lekë për produktin “Materiale mbrojtëse të blera për COVID-19”, për të cilin nuk ka pasur plan fillestar gjatë vitit 2022 dhe alokimi i fondeve është bërë me buxhetin e rishikuar. Produkti nuk rezulton i plotësuar me sasi dhe për pasojë nuk mund të gjykojmë mbi përdorimin e fondit në terma sasiorë si dhe arsyet e alokimit të tij.

Sa i përket shpenzimeve kapitale të programit, konstatohet që ato planifikohen për projektin “Kosto Lokale për PIU-n”, i cili në vetvete nuk përbën shpenzime të paguara për një produkt konkret me natyrë projekti, por janë shpenzimet të bëra të lidhura me angazhimin e palës shqiptare në kuadër të një projekti me financim të huaj. Në këtë program nuk gjejmë planifikim të projektit me financim të huaj me të cilin mund të lidhim këtë shpenzim, prandaj rezulton e paqartë pagesa e njesisë zbatuese të projektit nga ky program.

Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”

Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një rrjeti ekstensiv të përbërë nga qendra shëndetësore urbane dhe rurale si dhe nga ambulanca fshatrash. Ky program ofron shërbimet e kujdesit mjekësor bazë si dhe një paketë programesh parandaluese. Qëllimi i këtij programi buxhetor është “Mbulimi universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor”.

Ky program e realizon qëllimin e tij buxhetor përmes objektivave të mëposhtëm:

1. Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve.
2. Plotësim i qendrave shëndetësore në masën 80% me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor"		Plani Fillestar Viti 2022	Plani i Rishikuar Viti 2022	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike vjetore	Diferenca Plan-Fakt	% e realizimit
600	Paga	69,345	62,111	-7,234	62,044.24	67	100
601	Sigurime Shoqërore	11,581	10,541	-1,040	10,255.59	285	97
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	34,007	41,857	7,850	39,836.43	2,021	95
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	8,385,140	7,340,140	-1,045,000	7,340,140.00	0	100
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0.00	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	1,110	1,110	1,110.00	0	100
Nëntotali Shpenzime Korente		8,500,073	7,455,759	-1,044,314	7,453,386.26	2,373	100
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	2,500	2,500	2,491.04	9	100
231	Kapitale të Trupëzuara	147,052	68,412	-78,640	68,233.54	178	100
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		147,052	70,912	-76,140	70,724.58	187	100
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	160,883.27	-160,883	0
231	Kapitale të Trupëzuara	158,000	0	-158,000	11,372.59	-11,373	0
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		158,000	0	-158,000	172,255.86	-172,256	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale		305,052	70,912	-234,140	242,980.44	-172,068	343
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		8,805,125	7,526,671	-1,278,454	7,696,366.70	-169,696	102

Planifimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 8.8 miliardë lekë, ku **peshën më të lartë shpenzimeve (94%) e zë transferata buxhetore për llogari të skemës së FDSKSH** në masën 8.3 miliardë lekë. Transferata e alokuar në këtë program planifikohet për të përballuar shpenzimet për financimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, rimbursimin e barnave dhe pajisjeve të listës së rimbursueshm dhe shërbimin koncensionar të kontrollit bazë mjekësor (check-up). Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në këtë zë, duke u reduktuar me 1.045 miliardë lekë.

Rishikime ka pësuar dhe planifikimi i shpenzimeve kapitale të programit të cilat janë planifikuar fillimisht në masë 305 milionë lekë dhe pastaj janë reduktuar në masën 70.9 milionë

lekë. **Devijanca më e madhe rezulton kryesisht në planifikimin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj.** Pavarësisht planifikimit jo të qëndrueshëm buxhetor, realizimi faktik i programit rezulton në nivelin maksimal. Sa i përket projekteve me financim të huaj, pavarësisht rishikimit të planit në 0, në shpenzimet faktike kemi realizim në nivelin 172.2 milionë lekë grante, për të cilat nuk ka pasur plan buxhetor.

Programi paraqitet i qëndrueshëm në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre të lidhura me shpenzimet korrent. Produktet e programit janë të qëndrueshme që do të thotë janë përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore.

Ndërkohë, nuk mund të themi të njëjtën gjë për produktet/projektet e investimeve publike, të cilat rezultojnë në një planifikim jo të qëndrueshëm buxhetor.

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia Fillestare	Plani fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzimet Faktike
91303AA	Numri i vizitave në kujdesin parësor	6,400,000	2,268,104	6,400,000	1,493,790	8,008,042	1,491,417
91303AB	Persona qe perfitojne chek up	475,000	876,090	475,000	876,090	454,828	876,090
91303AC	Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes	400,000	5,355,879	400,000	5,085,879	400,831	5,085,879
91301AA	Akte ligjore e nënligjore të miratuara		0		0		3,803
18BA612	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksionin e qsh-ve dhe amb-ve per v.	0	0	17	2,500	17	2,491
20AB602	F.V. pajisje mobilimi per godinen e Drejtorise Qendrore te OSHKSH-se	0	0	15	258	45	258
20AB603	F.V. pajisje kompjuterike per godinen e Drejtorise Qendrore te OSHKSH-se	0	0	11	493	33	493
20AB607	F.V unite dentare per kujdesin dentar te femijet	14	14,000	14	11,132	42	11,132
20AB608	F. V pajisje mjekesore dhe mobilimi per qendrat shendetesore	0	0	25	3,819	50	3,819
20AB609	Blerje pajisje kompjuterike per njvksh Mat	0	0	0	600		589
20AB610	Blerje pajisje kompjuterike per njvksh Puke	0	0	0	600		591
20AB611	Blerje pajisje kompjuterike per njvksh Permet	0	0	0	600		588
20AB612	Blerje pajisje kompjuterike per njvksh Malesi e Madhe	0	0	0	600		556
20AB613	F.V pajisje per arkiven e njvksh Kruje	0	0	0	1,000		1,000
20AB614	Blerje pajisje kompjuterike per DROSHKSH Shkoder	0	0	0	700		663
20AB615	Blerje pajisje kompjuterike per DROSHKSH Tirane	0	0	0	700		663
20AB616	Blerje pajisje kompjuterike per njvksh Kukes	0	0	0	600		587
20AB701	Ndertim i godines se re per akomodimin e qsh1, njvksh dhe kl.	1,977	79,069	1,977	0		0
20AB702	Superv+kolaudim per ndertimin e godines se re per akomodimin e qsh1,	1	1,049	1	0		0
20AB703	Suuperv+kolaudim per rikonstruksione te godinave te njesive te kujdesit	1	934	1	783	1	783
20AB705	Rikonstruksione te godinave te njesive te kujdesit shendetesor ne rrethe	1,050	42,000	1,050	42,000	1,050	41,986
GM13021	Investime ne qendrat shendetesore te qarqeve Fier dhe Diber nga	1	70,000	1	0	1	157,081

KM13001	Rikonstruksion dhe pajisje 5 poliklinikave	1,600	88,000	1,600	0	250	11,373
M130334	TVSH, Detyrime Doganore (Paresori)	1	10,000	1	0		0
M132168	TVSH		0		738		738
M133959	Blerje pajisje		0		106		106
M134028	F.V pajisje mjekesore dhe mobilimi per qendra shendetesore	0	0	135	3,683	135	3,683

Produktet e financuara nga shpenzimet korrent, konkretisht:

- Numri i vizitave në kujdesin parësor;
- Persona që përfitojnë check-up;
- Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes.

Kanë një trend të qëndrueshëm në terma përfituesish dhe shpenzimesh. Por vërehet që produkti “**Numri i vizitave në kujdesin parësor**” ka një numër faktik të lartë prej 8 milionë vizitash krahasuar me planifikimin fillestar dhe atë të rishikuar prej 6.4 milionë lekë. Kjo nënkupton që kosto për njësi faktike e shërbimit të ofruar nga qendrat shëndetësore për vizita ulet ndjeshëm. Për më tepër fondet nga ky produkt në këtë program janë pakësuar me buxhetin e rishikuar duke bërë që kostoja për njësi për vizita të ulet akoma më shumë. **Në këtë kontekst, vihet në diskutim planifikimi buxhetor i bërë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i cili rezulton jo realist krahasuar me realizim faktik në fund të vitit.**

Sa i përket produktit “**Persona që përfitojnë check up**”, theksojmë që shpenzimet janë fikse dhe paguhen sipas kushteve koncensionare bazuar në tavanin e numrit të përfituesve të vendosur në kushtet e kontratës koncensionare. Për vitin 2022, kanë përfituar nga shërbimi i check up-it 454 828 pacientë nga 475 000 të planifikuar sipas kushteve të kontratës. Në këtë rast, pagesa e koncensionarit është bërë për 475 mijë përfitues, pavarësisht se realisht nga shërbimi kanë përfituar 454 828 pacientë, ose 20 182 pacientë më pak.

Për vitin 2022, kanë qenë **400 831 Pacientë** që janë trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes nga **400 000 të planifikuar me buxhetin e vitit 2022** për këtë program dhe janë shpenzuar nga buxheti i shtetit për rimbursimin e barnave 5.085 miliardë lekë. Në këtë llogaritje nuk janë përfshirë pjesa e shpenzimeve të kryera nga FDSKSH nga të ardhurat e tyre.

Produktet e financiar nga shpenzimet kapitale paraqiten me luhatshmëri të lartë krahasuar me produktet e planifikuara për shpenzimet korrente.

Konkretisht me buxhetin fillestar për vitin 2022 ishin planifikuar 8 projekte investimesh për t’u realizuar. Ndërkohë, referuar rishikimeve buxhetore gjatë vitit 2022, 5 nga 8 projektet e investimeve publike bëhen zero dhe rialokohen fondet në projekte të tjera të cilat nuk kanë qenë parashikuar në Dokumentin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të miratuar nga MSHMS.

Projektet ku janë rialokuar këto fonde janë kryesisht projekte për blerje pajisjesh kompjuterike në njësitë e kujdesit shëndetësor në rrethe dhe nuk ka asnjë arsye specifike

të përmendur në raportet e MSHMS për këtë zhvendosje të fondeve të planifikuara nga projekte ndërtimesh e rikonstruksionesh në blerje pajisjesh kompjuterike.

Nëse do t'i analizojmë projektet sipas burimit të financimit për projektet me financim të brendshëm, konstatojmë që projektet që kanë pasur progresin më të mirë në terma sasiorë dhe financiarë janë:

- Projekti “*Rikonstruksione të godinave të njësisë të kujdesit shëndetësor në rrethe*”. Konkretisht janë planifikuar dhe realizuar **1050 metra katror rikonstruksione të godinave** dhe janë shpenzuar **41.9 milionë lekë nga 42 milionë lekë të planifikuara**.
- Projekti “*F.V unite dentare për kujdesin dentar të fëmijët*” janë blerë 42 pajisje krahasuar me 14 të planifikuara dhe është shpenzuar fondi në masën 11.1 milionë lekë nga 14 milionë lekë të planifikuara.
- Projektet e tjera me financim të brendshëm janë projektet e lidhura me blerjen e pajisjeve kompjuterike për NJKSH në rrethe, projekte të cilat janë financuar me rishikime buxhetore gjatë vitit 2022.

Për projektet me financim të huaj progres kanë pasur dy projekte e konkretisht:

- **Investime në qendrat shëndetësore të qarqeve Fier dhe Dibër** nga Kooperacioni Zviceran (grant) në shumën faktike prej 157 milionë lekë nga 70 milionë të planifikuar në buxhetin fillestar.
- **Rikonstruksion dhe pajisje 5 poliklinikave-kredi e qev.italiane- KREDI** në shumën 11 milionë lekë nga 88 milionë të planifikuar në buxhetin fillestar.

Lidhur me produktet e analizuar të këtij programi, veçanërisht produktet e lidhura me shpenzimet kapitale, konstatohet se në të dhënat zyrtare të MSHMS nuk ka materiale të mjaftueshme analizash të rezultateve të projekteve të investimeve publike. Jepet informacion mbi realizimin financiar të tyre por mungon informacioni në terma sasiorë, përmendim këtu investimet e bëra në qendrat shëndetësore të Fierit dhe Dibrës nga granti i Kooperacionit Zviceran, që përveç emrit të projektit, nuk del qartë çfarë investimesh konkrete janë kryer në këto qendra.

Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”

Ky program siguron ofrimin e shërbimit spitalor në kohë dhe cilësi, harmonikisht në të gjithë vendin, duke ulur mortalitetin dhe shkallën e invaliditetit. Qëllimi i këtij programi buxhetor është “Mbulim universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar”.

Ky program e realizon qëllimin e tij buxhetor përmes objektivave të mëposhtëm:

1. Ofrimi cilësor dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor.
2. Trajtimi i pacientëve për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia;
3. Trajtimi stimulues i personelit shëndetësor në vijën e parë në luftën ndaj pandemisë COVID-19.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Programi "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytesor"		Plani Fillestar	Plani Vjetor i Rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike Vjetore	Diferenca Plan i Rishikuar - Fakt	% e Realizimit
600	Paga	599,238	542,792	-56,446	540,449.03	2,343	100%
601	Sigurime Shoqërore	100,073	91,671	-8,402	89,227.52	2,443	97%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	865,745	795,035	-70,710	763,949.73	31,085	99.20
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0.00
604	Transferta Korente të Brendshme	29,465,860	29,465,860	0	29,297,830.25	168,030	99.10
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0.00	0	0.00
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	10,786	10,786	10,755.91	30	97.90
Nëntotali Shpenzime Korente		31,030,916	30,906,144	-124,772	30,702,212.45	203,755	97.90
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	2,575	2,575	2,574.99	0	97.90
231	Kapitale të Trupëzuara	1,159,212	918,637	-240,575	916,553.61	2,083	97.90
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		1,159,212	921,212	-238,000	919,128.60	2,083	97.90
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	123,834.90	-123,835	97.90
231	Kapitale të Trupëzuara	1,152,000	1,826,645	674,645	1,719,941.76	106,703	97.90
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		1,152,000	1,826,645	674,645	1,843,776.67	-17,132	97.90
Totali i Shpenzimeve Kapitale		2,311,212	2,747,857	436,645	2,762,905.26	-15,049	97.90
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		33,342,128	33,654,001	311,873	33,465,118	188,706	97.90

Planifikimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 33.34 miliardë lekë, ku **peshën më të lartë shpenzimeve (88%) e zë transferta buxhetore për llogari të skemës së FDSKSH** në masën **29.46 miliardë lekë**. Transferta e alokuar në këtë program planifikohet për të përballuar shpenzimet për financimin e shërbimit shëndetësor spitalor. Ndërkohë, nga buxheti i shtetit për vitin 2022 financohet tërësisht aktiviteti i spitaleve Memorial Fier dhe Rajonal Durrës, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në zërin e shpenzimeve kapitale duke u rritur me 436.6 milionë lekë. **Programi paraqitet me një realizim të mirë të shpenzimeve të tij në nivelin prej 97.9%** krahasuar me buxhetin e rishikuar.

Sa i përket realizimit të buxhetit të këtij programi në terma produktesh dhe projektsh më poshtë në sasi dhe kosto do të analizojmë performancën e programit, duke ndarë më vete produktet e financuara nga shpenzimet korrent dhe më vete produktet/projektet nga shpenzimet kapitale.

Në lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia fillestar	Plani Fillestar	Kosto për Njësi sipas planit fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i Rishikuar	Kosto për Njësi sipas Planit të Rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzime Faktike	Kosto për Njësi Faktike
91304AA	Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalor	330,000	24,265,498,000	73,532	330,000	24,370,428,000	73,850	277,881	24,286,055,034	87,397
91304AB	Pacientë të trajtuar me dializë	234,000	2,800,000,000	11,966	234,000	2,552,325,000	10,907	193,878	2,489,491,080	12,841
91304AC	Pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike	934	826,784,000	885,208	934	769,179,000	823,532	1,492	756,528,062	507,056
91304AD	Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjise dhe kardiokirurgjise	8,600	1,249,000,000	145,233	8,600	1,147,906,000	133,477	9,365	1,143,793,250	122,135
91304AE	Pacientë të trajtuar nga paketat e transplanteve renale	26	36,780,000	1,414,615	26	30,000,000	1,153,846	13	30,000,000	2,307,692
91304AF	Pacientë të trajtuar me katarakte	4,500	93,150,000	20,700	4,500	61,000,000	13,556	3,790	56,989,755	15,037
91304AG	Pacientë të trajtuar me radioterapi	26,000	147,300,000	5,665	26,000	119,304,000	4,589	24,933	114,999,999	4,612
91304AH	Pacientë me sindromën down	25	25,000,000	1,000,000	25	0	0		0	
91304AK	Ekzaminime laboratorike	4,600,000	1,340,241,000	291	4,600,000	1,639,002,000	356	4,205,767	1,624,799,783	386
91304AL	Pacientë të trajtuar në QKMZHF	450	84,114,000	186,920	450	77,284,000	171,742	1,506	75,758,229	50,304
91304AM	Barna dhe Pajisje Mjekesore të regjistruara	820	162,049,000	197,621	820	139,716,000	170,385	3,154	123,974,286	39,307
91304AO	Cifte që perfitojne nga paketa e fertilitetit	4	1,000,000	250,000	4	0	0		0	

Produkti kryesor i këtij programi për pjesën e shpenzimeve korrent është produkti **“Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalor”**. Në vitin 2022 kanë përfituar trajtim në shërbimin spitalor 277 881 pacientë nga 330 000 të planifikuar me buxhetin fillestar e të rishikuar për këtë vit. Ajo që bie në sy është ndryshimi i ndjeshëm i kostos për njësi të këtij shërbimi, e cila luhet nga kostoja mesatare për njësi e planifikuar prej 73 850 lekë në 87 397 lekë kostoja faktike për njësi, pra rezulton 18% më e lartë se plani. Në të dhënat zyrtare të MSHMS nuk gjejmë argumente mbi këtë ndryshim kostoje të ndjeshme të shërbimit.

Kanë përfituar nga shërbimi i trajtimit me dializë 193 878 pacientë nga 234 000 të planifikuar me buxhetin e vitit 2022. **Produkti “Pacientë të trajtuar me dializë”** ka një ecuri normale në terma të sasisë dhe koston së lidhur me të.

Produkti **“Pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike”** rezulton problematik në terma të sasisë së realizuar dhe për pasojë të koston për njësi. 1492 pacientë kanë marrë trajtim në këto spitale ndërkohë që janë planifikuar 934 të tillë. Devijanca e madhe e numrit rezulton dhe me një ulje të

ndjeshme të koston për njësi të shërbimit, duke vënë në diskutim ose cilësinë e shërbimit të ofruar për pacientë ose planifikimin e dobët buxhetor të bërë nga MSHMS.

Produktet **“Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë”**, **“Pacientë të trajtuar nga paketa e transplanteve renale”**, **“Pacientë të trajtuar me katarakte”**, **“Pacientë të trajtuar me radio terapi”**, kanë një ecuri normale të terma të sasisë dhe koston së planifikuar.

Në këtë program është parashikuar dhe pagesa e koncensionarit për kontratën koncensionare të ofrimit të shërbimit të laboratorëve e lidhur me produktin **“Ekzaminime laboratorike”**, sipas të cilët janë realizuar 4.2 milionë ekzaminime nga 4.6 milionë të planifikuar me 1.62 miliardë lekë të shpenzuara për vitin 2022 për këtë shërbim.

Ajo që konstatohet në monitorimin e performancës së produkteve të këtij programi është planifikimi fillestar i vitit 2022 për dy produkte **“Pacientë me Sindromën Down”** dhe **“Çifte që përfitojnë nga paketa e fertilitetit”** dhe heqja e tyre në vazhdim gjatë vitit 2022. Në raportet e monitorimit të publikuar nga MSHMS dhe MFE nuk ka asnjë arsye apo argument të parashtruar për heqjen e financimit të këtyre produkteve. Theksojmë që produkti **“Çifte që përfitojnë nga paketa e fertilitetit”** përbënte një iniciativë të re të nisur nga MSHMS si rezultat i rekomandimeve të marra në Komisionet e Kuvendit gjatë miratimit të projektbuxhetit për vitin 2022. Politika u financua fillimisht dhe rezultoi e anuluar gjatë vitit pa arsye të qënësishme.

Sa i përket projekteve të investimeve publike për programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”**, vërejmë se ky është programi me numrin më të madh të projekteve të investimeve publike për sektorin e shëndetësisë. Referuar performancës gjatë vitit 2022, konstatohet që janë hapur 5 produkte të reja, nga të cilat vetëm **Produkti “Rikonstruksion i Farmacisë dhe Dispanserisë së Spitalit të Vlorës” paraqet një projekt konkret**, ndërsa produktet e tjera rezultojnë të jenë shpenzime të lidhura me këtë projekt, si supervizioni dhe kolaudimi apo taksa e infrastrukturës. Performanca e këtij produkti **“Rikonstruksion i Farmacisë dhe Dispanserisë së Spitalit të Vlorës”** rezulton sipas planit në terma financiarë dhe sasiorë.

Në lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia fillestare	Plani Fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i Rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzime Faktike
22AC601	Rikonstruksioni i Farmacisë dhe Dispanserise sp.Vlore	0	0	330	39,066,614	330	39,066,614
22AC602	Superv+kolaudim per Rikonstruksioni i Farmacisë dhe Dispanserise sp.	0	0	1	590,186	1	590,185
22AC603	Lidhja e re e energjise elektrike per godinen e re A2 te semundjeve te	0	0	0	6,458,386	0	6,458,386
22AC604	Takse infrastrukture per azhornim leje ndertimi per projektin:	0	0	1	4,477,617	1	4,477,617
22AC606	TVSH per 5 Poliklinikat (Gjirokastra+ Peshkopi)- kredi e qev italiane	0	0	1	1,569,170	0	1,569,169

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, raporti i monitorimit vjetor 2022

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia fillestare	Plani Fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i Rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzime Faktike
18BB007	Rikonstruksion i QKMZHRF Tirane	180	10,000,000	180	9,169,600	510	9,169,581
18BB008	"Rikonstruksion i godines se QKTGjakut Tirane"	982	54,046,000	982	88,059,200	1,602	88,059,200
18BB024	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e QKMZHRF Tirane	1	1,350,000	1	1,054,717	3	1,054,717
18BB025	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godines se QKTGjakut Tirane	1	451,000	1	966,184	1	958,600
18BB045	Rikonstruksion i godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe Obstetrikës dhe	1,127	75,537,000	1,127	0		0
18BB046	Supervizion per rikonstruksionin e godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe	1	4,648,000	1	0		0
18BB052	Rikonstruksion i pediatrie se sp.Durres -shtese kontrate	0	0	0	0		0
18BB057	Rikonstruksion i godines se pediatrie sp.Elbasan	5,470	107,508,000	5,470	102,646,771	12,336	102,646,771
18BB058	Supervizion+kolaudim per rikonstruksionin e godines se pediatrie sp.	1	3,400,000	2	2,895,755	2	2,895,755
18BB061	Rikonstruksion i sallave të lindjes, repartit të neonatologjisë dhe repartit i	0	0	530	26,938,691	824	26,938,255
18BB062	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e sallave të lindjes, repartit të	0	0	2	623,281	2	623,281
18BB073	TVSH per pajisje ne kuader te luftes kunder COVID	369	41,244,000	0	0	0	0
18BB074	Rikonstruksione ne spitalin rajonal Kukes- shtese kontrate	0	0	250	0	0	0
18BB075	Supervizion+kolaudim per rikonstruksione ne spitalin rajonal Kukes -	0	0	2	0	0	0
18BB076	Punime per pjesen teknologjike te fazes II te rikonstruksionit te sp.Kukes	1,568	94,106,000	968	59,405,263	968	59,405,263
18BB077	Supervizion dhe kolaudim per kryerjen e punimeve per pjesen	1	1,360,000	2	1,360,000	1	1,180,968
18BB079	Rikonstruksion i godines se Arkives se Kartelave Mjekesore ne QSU Nene	0	0	0	2,500,044	325	2,500,044
18BB080	Supervizion dhe kolaudim per rikonstruksionin e godines se Arkives se se Kartelave Mjekesore ne QSU Nene	0	0	1	48,791	2	48,791
18BB103	"F.V aparatura mjekesore per spitali e ri te ndertuar ne QSUT me kredi te	989	210,809,000	989	204,733,200	989	204,733,199
18BB116	Pajisje mjekesore per spitalet te blera	55	22,296,000	55	0		0
18BB119	Pajisje per QKMZHRF Tirane	676	23,673,000	676	0		0
18BB123	F.V pajisje teknologjike per fazen I sp.Kukes	0	0	155	2,301,702	155	2,301,432
18BB124	Superv+kolaudim per f.v pajisje teknologjike per fazen I sp.Kukes	0	0	2	723,325	1	646,552
18BB147	Projekt -preventiva zbatimi per rikonstruksionin e pavionit te semureve	0	0	1	2,575,000	1	2,574,990
18BB148	F.V pajisje mobilimi per farmacine dhe dispancerine e sp.Vlore	0	0	155	3,359,900	155	3,359,900
18BB149	F.V pajisje mjekesore, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekesore per	0	0	35	25,000,000	35	25,000,000
18BB150	Furnizimi vendosje pajisje biomjekesore per sherbimin e okulistikes sp.	0	0	25	16,794,000	25	16,669,200
18BB152	Furnizim vendosje pajisje mjekesore per sherbimet mjekesore dhe	0	0	5	10,620,000	5	9,640,799
18BB153	TVSH per Grantin Japonez	0	0	1	2,883,888	1	2,883,888
18BB154	F.V pajisje dhe orendi per disa nga sherbimet e QSUT	0	0	0	12,096,000	135	12,096,000
18BB155	F.V UPS per aparaturat e laboratorit ne sp.psiikiatrik Vlore	0	0	1	123,000	1	119,500
18BB211	Pagese TVSH-je per sherbimin e supervizimit per ndertimin e spitalit te	0	0	1	2,400,000	1	2,399,910
18BB212	Kosto Lokale per PIU-n (njesia e zbatimit te projekteve te huaja)	0	0	1	2,218,868	1	1,725,308
18BB213	Pagese kosto lokale per sherbimin e supervizimit per ndertimin e spitalit	0	0	1	12,000,000	1	12,000,000
18BB309	Projekti Emergjencia Covid-19- kredi e Bankes Boterore	1,840	400,000,000	1,840	825,000,000	190	704,705,665
18BB310	F.V. pajisje teknologjike, elektrike per godinen ekzistuese te pediatrie,	35	27,977,000	35	0		0
18BB311	Pagese e takses se infrastruktures per rikonstruksionin e godines se	0	0	1	23,697,664	1	23,697,664
18BB403	Projekt ne kuader te IPA-Interreg "Promoting health in cbc area by	1	15,000,000	1	6,644,500	1	3,000
19AD307	Rikonstruksion i pediatrie infektive ne QSUT		0		17,020,605		17,020,605
19AD308	Supervizion per rikonstruksionin e pediatrie infektive ne QSUT		0		371,542		371,542
20AB606	F.V pajisje per matjen e densitometrise kockore per strukturat		0		14,160,000		14,160,000
21AA101	Përmirësim i sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për AKBPM	1	126,360,000	1	117,875,720	1	117,657,720

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, raporti i monitorimit vjetor 2022

Projektet dhe produktet me financim të brendshëm të këtij programi rezultojnë të shumta në sasi (44 produkte) dhe kryesisht janë projekte në vazhdim të nisura që nga viti 2018. 18 prej tyre rezultojnë të çelur që në fillim të vitit 2022 dhe kanë performancë financiare dhe sasiore.

Përmendim këtu projektet kryesore të realizuara nga MSHMS në këtë program:

- Përmirësim i sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në vlerën e realizuar 117.6 milionë lekë;
- Projekti Emergjencë COVID-19- kredi e Bankës Botërore në vlerën e realizuar prej 704 milionë lekë;
- Furnizim dhe vendosje aparatura mjekësore për spitalin e ri të ndërtuar në QSUT me vlerë të realizuar 204.7 milionë lekë;
- Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë së Spitalit të Elbasanit me vlerë të realizuar 102.6 milionë lekë;
- Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë në shumën 88.06 milionë lekë.

Krahas kësaj, vihet re që planifikimi fillestar i buxhetit për investimet publike për këto programe rezulton i dobët, pasi gjatë vitit janë rialokuar fonde për 14 produkte të cilat nuk rezultojnë të financuara me buxhetin fillestar për vitin 2022. Kryesojnë listën projektet/produktet e lidhura me furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve mjekësore në spitale të ndryshme të QSUT dhe atyre rajonale.

Në përfundim nuk mund të analizojmë rezultatet konkrete të këtyre projekteve/produkteve pasi përveç sa na lë të nënkuptojmë emërtesa në raportet e publikuara nga institucionet përgjegjëse nuk ka informacione të tjera të hollësishme.

Në lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia fillestare	Plani Fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i Rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzime Faktike
G037018	Projekti Pharem		0		0		1,276,220
GM13009	Fuqizimi I pergjigjes kombetare ndaj HIV/AIDS (Global Fund)	1	30,000,000	1	75,000,000	1	115,147,035
GM13020	Programi I reformimit te QSUT Faza II		0		6,000,000		6,803,200
KM13017	FAZA E DYTE E ZBATIMIT TE MASTER-PLANIT TE QSUT- kredi e CEB-it		0		400,000,000		430,948,713
KM13018	FAZA E DYTE E ZBATIMIT TE MASTER-PLANIT TE QSUT- kredi e CEB-it	4,716	415,000,000	4,716	0		0
KM13020	Projekti i Bankes Boterore (i ndare ne tre komponente si vijojne) KREDI	4,424	292,000,000	4,424	0		0
KM13021	Permirësimi i sistemit te shendetesise		0		514,000,000		584,892,832
M130333	Kosto Lokale (Kontrib. Qev. Shqip. per Spit. Ri QSUT-CEB)	1	236,328,000	1	0		0
M130335	TVSH, Detyrime Doganore (Spitalori)	1	28,365,000	1	2,881,974	1	2,881,955
M133471	TVSH Ndertimi I Spitalit te Semundjeve Interne Q.S.U.T.	1	89,754,000	1	99,545,342	3	99,545,238

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, raporti i monitorimit vjetor 2022

Lidhur me projektet me financim të huaj (Kredi dhe Grant), janë alokuar fonde për 3 projekte në fillim të vitit 2022 (6 produkte përfshirë këtu kosto lokale dhe TVSH) nga të cilat 1 Grant dhe 2

Kredi të cilat kanë performuar mirë gjatë vitit 2022 në terma financiarë. Por konstatohet një inkonsistencë në raportimin e planit dhe faktit të këtyre projekteve. Konkretisht regjistrohet plani në një produkt tjetër në sistemin e thesarit (KM 13018) dhe fakti raportohet në një produkt tjetër të këtij projekti KM13017. Përveç mungesës së koherencës në raportimin financiarë, gjë e cila vështirëson analizën e performancës së këtyre projekteve, vërejmë që në raportet e monitorimit të publikuara nga institucionet përgjegjëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të analizuar performancën e projekteve në terma sasiorë dhe rezultatesh konkrete të arritura.

Programi “Shërbime të Shëndetit Publik”

Shërbimi i shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC< HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Qëllimi i këtij programi është “Mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetës së shëndetshme”. Ky program e realizon qëllimin e tij përmes objektivave të mëposhtëm:

1. Sigurimi i qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinale;
2. Reduktimi i numrit të shpërthimeve epidemike;
3. Mbulimi me inspektime në Spitale, Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendra Shëndetësore;
4. Mbulimi i grave me shërbim të depistimit të kancerit të gjirit dhe depistimin e kancerit të qafës së mitrës;

Në 000/lekë

Programi "Shërbime të Shëndetit Publik"		Plani Fillestar Vjetor Viti 2022	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2022	Ndryshimi I planit vjetor	Shpenzime Faktike Vjetore	Diferenca Plani I Rishikuar - Fakt	Realizimi ne %
600	Paga	2,194,767	2,098,977	-95,790	2,076,784.03	22,192.61	99
601	Sigurime Shoqërore	366,612	348,447	-18,165	342,281.84	6,165.16	98
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	652,579	556,001	-96,578	524,846.01	31,154.99	94
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0.00	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0.00	0.00	0
605	Transferta Korente të Huaja	3,132,508	1,899,907	-1,232,601	1,874,745.61	25,161.39	99
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	37,702	37,702	37,622.40	79.95	100
	Nëntotali Shpenzime Korente	6,346,466	4,941,034	-1,405,432	4,856,279.90	84,754.10	98
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	13,680	13,680	0	13,675.17	4.83	100
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	13,680	13,680	0	13,675.17	4.83	100
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0.00	0.00	0
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0.00	0.00	0
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	13,680	13,680	0	13,675.17	4.83	100
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	6,360,146	4,954,714	-1,405,432	4,869,955.08	84,758.92	98

Planifikimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 6.36 miliardë lekë, ku **peshën më të lartë shpenzimeve (49%) e mbante në fillim të vitit 2022 transferta buxhetore korrent të huaja** në masën 3.1 miliardë lekë. Transferata e alokuar në këtë program është planifikuar për të përballuar shpenzimet për financimin e vaksinës kundër COVID-19. Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në këtë zë, duke u reduktuar me 1.2 miliardë lekë, pasi ra ndjeshëm numri i pacientëve që kryenin dozën e tretë të vaksinës kundër COVID-19. **Planifikimi i shpenzimeve kapitale të programit nuk ka qenë i qëndrueshëm**, duke rezultuar në devijanca nga plani fillestar i projekteve. Pavarësisht kësaj, fondi financiar është i alokuar për këtë zë është realizuar 100%, duke u rialokuar në produkte/projekte të tjera gjatë vitit. Ky program nuk ka pasur projekte me financim të huaj të planifikuar përgjatë vitit 2022. Pavarësisht **planifikimit jo të qëndrueshëm buxhetor referuar zërave të shpenzimeve korrent** të lidhura me fondet e dedikuara për blerjen e vaksinës kundër COVID-19 dhe rialokimeve të bëra në shpenzimet kapitale, realizimi faktik i programit **rezulton në nivelin maksimal**.

Programi paraqitet i qëndrueshëm në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre të lidhura me shpenzimet korrent. Produktet e programit janë të qëndrueshme, që do të thotë janë në përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore. **Ndërkohë**, nuk mund të themi të njëjtën gjë për **produktet/projektet e investimeve publike të cilat rezultojnë në një planifikim jo të qëndrueshëm buxhetor**.

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Në 000/lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia fillestare	Plani fillestar	Sasia sipas planit të rishikuar	Plani i Rishikuar	Sasia Faktike	Fakti
91305AA	Fëmijë të vaksinuar 0-18	203,000	312,508	203,000	298,008	240,000	297,945
91305AB	Numer kontrollesh për situatat epidemiologjike	3,400	2,515,885	3,400	2,350,237	4,010	2,312,732
91305AC	Kontrolle dhe inspektime të kryera nga inspektoratet	25,000	423,569	25,000	367,099	22,992	356,519
91305AD	Gra të depistuar për kancerin e gjirit	4,500	12,383	4,500	12,383	5,423	12,383
91305AE	Inspektime të kryera nga Operatori Kujdesit Shëndetësor në Spitale, Niësi	710	225,521	710	252,718	405	243,782
91305AF	Gra të depistuar për kancerin e qafës së mitrës	16,000	36,600	16,000	15,600	10,400	15,108
91305AG	Personel mjekësor dhe jo-mjekësor i trajtuar me bonus për Covid-19	0	0	0	14,040	175	13,565
91305AH	Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19	2,000,000	2,700,000	2,000,000	1,487,699	534,536	1,462,683
91305AI	Persona të vaksinuar me vaksinën e gripit sezonal	250,000	120,000	250,000	114,200	239,570	114,118
91305AJ	Institucione shëndetësore dhe shoqërore të akredituara	0	0	20	29,050	260	27,444
18BB507	Rikonstrukcion dhe shtese për godinën e ISHP Tirane	206	13,480	206	0		0
18BB508	Superv+ kolaudim për rikonstrukcion dhe shtese për godinën e ISHP	1	200	1	0		0
18BB605	Blerje pajisje kompjuterike për ISHP	0	0	20	487	20	483
18BB606	Blerje pajisje aspirimi për vivariumin e ISHP	0	0	2	36	2	36
18BB705	Pagese tvsh dhe takse doganore për disa pajisje dhe automjete në kuadër	0	0	1	4,286	1	4,286
20AB607	F.V unite dentare për kujdesin dentar të fëmijet		0		8,870		8,870

- Janë vaksinuar **240 mijë fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç**, nga 203 mijë të planifikuar për vitin 2022, duke shpenzuar 297.9 milionë lekë nga buxheti i planifikuar dhe rishikuar prej 298 milionë lekë.
- Janë kryer **4010 kontrole për situatat epidemiologjike**, nga 3400 të planifikuar, duke shpenzuar 2.3 miliardë lekë nga 2.35 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Vihet re një inkonsistencë mes sasisë së planifikuar për t'u realizuar dhe realizimit faktik të këtij produkti, duke vënë në dyshim planifikimin e kostos së këtij produkti.
- Janë kryer **22 992 kontrole dhe inspektime nga inspektoriatet shëndetësore**, nga 25 000 të planifikuar, duke shpenzuar 356.5 milionë lekë nga 367 milionë të planifikuar dhe rishikuar me buxhetin e vitit 2022.
- Janë **depistuar 5423 gra për kancerin e gjirit nga 4500 të planifikuar**, duke shpenzuar të gjithë fondin e planifikuar për këtë qëllim në masën 12.4 milionë lekë. Vihet re një inkonsistencë mes sasisë së planifikuar për t'u realizuar dhe realizimit faktik të këtij produkti, duke vënë në dyshim planifikimin e kostos së këtij produkti.
- **Janë kryer 405 inspektime nga Operatori i Kujdesit Shëndetësor në Spitalet Njësi**, nga 710 të planifikuar, duke shpenzuar 243 milionë lekë nga 252 milionë lekë të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Vihet re një inkonsistencë mes sasisë së planifikuar për t'u realizuar dhe realizimit faktik të këtij produkti, duke vënë në dyshim planifikimin e kostos së këtij produkti.
- **Janë depistuar 10 400 gra për kancerin e qafës së mitrës**, nga 16 000 të planifikuara, duke shpenzuar 15.1 milionë lekë nga 15.6 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar.
- Janë trajtuar 175 Personel mjekësor dhe jo mjekësor me bonus për COVID-19, duke shpenzuar 13.5 milionë lekë për këtë qëllim. Vihet re që ky produkt nuk është planifikuar në fillim të vitit 2022. Në materialet e publikuara nga MSHMS nuk paraqiten arsyet e këtij rishikimi.
- **Janë vaksinuar 534 536 persona me vaksinën anti-COVID-19 nga 2 000 000 të planifikuar me buxhetin fillestar për vitin 2022**, duke shpenzuar 1.4 miliardë lekë nga 2.7 miliardë lekë të planifikuar me buxhetin fillestar për vitin 2022. Vihet re një dyfishim i kostos për njësi të vaksinës nga 1350 Lekë sipas planifikimit fillestar në 2720 lekë referuar realizimit faktik. **Mungojnë arsyet konkrete që të justifikojnë koston totale të vaksinimit i cili referuar kosto për njësi të planifikimit fillestar duhet të kishte kushtuar shumë më pakë.**
- **Janë vaksinuar 239 570 persona me vaksinën e gripit sezonal** nga 250 000 të planifikuar, duke shpenzuar 114 milionë lekë nga 114.2 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2022.
- **Janë realizuar 260 akreditime nga institucionesh shëndetësore nga 20 të planifikuar**, duke shpenzuar 27.4 milionë lekë nga 29 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Vihet re që ky produkt nuk është planifikuar në fillim të vitit 2022. Në materialet e publikuara nga MSHMS nuk paraqiten arsyet e këtij rishikimi. Për më tepër vihet re një inkonsistencë mes sasisë së planifikuar për t'u realizuar dhe realizimit faktik të këtij produkti, duke vënë në dyshim planifikimin e kostos së këtij produkti.
- **Sa i përket planifikimit të investimeve publike**, vihet re që në fillim të vitit 2022 është planifikuar një projekt rikonstruksioni i Godinës së ISHP në vlerën 13.6 milionë lekë, projekti i cili nuk është realizuar dhe fondet janë rialokuar gjatë vitit në projekte të tjera të

lidhura me blerje pajisjesh dhe kompjuterë. Në raportet e monitorimit të publikuara nga MSHMS mungojnë arsyet pse nuk është realizuar projekti sipas planit.

Programi “Shërbime Kombëtar i Urgjencës Mjekësore”

Ky program synon të zhvillojë shërbimin e urgjencës mjekësore si pjesë integrale e sistemit shëndetësor, të sigurojë ofrimin e ndihmës urgjente mjekësore në kohë dhe cilësi, në të gjithë vendin, si dhe të rrisë vetëdijen e popullatës mbi përparësitë e përdorimit korrekt të shërbimit të urgjencës mjekësore.

Qëllimi i këtij programi është “Për një shërbim të urgjencave mjekësore në nivel qendror efektiv dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të popullatës”. Ky program e realizon qëllimin e tij përmes objektivit të mëposhtëm:

1. Adresimi me efektivitet i thirrjeve për urgjenca mjekësore në nivel qendror.

Në 000/lekë

Programi Shërbimi Kombëtar i Urgjencës		Plani Fillestar	Plani Vjetor i Rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike	Ndryshim Plan i rishikuar Fakt	Realizimi ne %
600	Paga	110,410	107,650	-2,760	105,980.35	1,670	98
601	Sigurime Shoqërore	15,098	18,221	3,123	17,536.82	684	96
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	208,654	114,289	-94,365	107,942.75	6,346	94
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0.00	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0.00	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	1,535	1,535	1,534.90	0	100
Nëntotali Shpenzime Korente		334,162	241,695	-92,467	232,994.82	8,700	96
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		0	0	0	0.00	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të hu		0	0	0	0.00	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale		0	0	0	0.00	0	0
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		334,162	241,695	-92,467	232,994.82	8,700	96

Planifikimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 334.2 milionë lekë dhe është i gjithi për pjesën e shpenzimeve korrent, pasi për këtë program për vitin 2022 nuk janë planifikuar projekte investimi publike. Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, duke u reduktuar me **94.4 milionë lekë**.

Programi paraqitet i qëndrueshëm në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre të lidhura me shpenzimet korrent. Produktet e programit janë të qëndrueshme, që do të thotë janë në përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore.

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Në 000/lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia Fillestar	Plani fillestar	Sasia e rishikuar	Plani I rishikaur	Sasia Faktike	Shpenzime faktike
91306AA	Raste te trajtuara nga njesite e urgjences mjekesore	650,000	334,162	125,000	241,695	119,728	232,995

Sikurse shihet, programi ka vetëm një produkt, konkretisht “Raste të trajtuara nga njësitë e urgjencës mjekësore”. Janë trajtuar 119 728 raste nga 125 000 të planifikuara me rishikimin e buxhetit. Ndërkohë që është shpenzuar 232.9 milionë lekë nga 241.7 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Ajo që konstatohet është planifikimi i dobët fillestar i bërë për këtë produkt sipas të cilit planifikoheshin të trajtoheshin 650 mijë raste urgjence, duke vënë në diskutim dhe kosto për njësi të planifikuar të këtij shërbimi.

Programi “Përkujdesi Social”

Ky program mbështet nëpërmjet pagesave në kesh, me ndihmë ekonomike dhe shërbime shoqërore, familjet dhe individët në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, psikologjike e shoqërore.

Qëllimi i këtij programi është “Ndërtimi i në sistemi mbrojtje sociale nëpërmjet politikave dhe mekanizmave për të mbrojtur individët në nevojë” dhe realizohet përmes përmbushjes së objektivave të mëposhtëm:

1. Reformimi i programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij : NE, PAK dhe shërbimet sociale;
2. Përfshirja e barabartë sociale dhe ekonomike e burrave dhe grave, fëmijëve dhe grupeve të marginalizuara;
3. Riintegrimi social ekonomik i grupeve te marginalizuara.

Në 000/lekë

Programi Përkujdesja Sociale		Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike	Ndryshimi Plan i Rishikuar - Fakt	Realizime %
600	Paga	528,817	515,147	-13,670	512,114.41	3,033	99
601	Sigurime Shoqërore	88,313	87,140	-1,173	85,587.27	1,553	98
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	331,000	304,900	-26,100	300,417.50	4,483	99
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0.00	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0.00	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	25,750,000	28,759,644	3,009,644	28,571,683.65	187,960	99
	Nëntotali Shpenzime Korente	26,698,130	29,666,831	2,968,701	29,469,802.81	197,028	99
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	20,000	3,640	-16,360	3,180.84	459	87
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	20,000	3,640	-16,360	3,180.84	459	87
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	42.38	-42	0
231	Kapitale të Trupëzuara	100,000	20,000	-80,000	20,970.29	-970	105
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	100,000	20,000	-80,000	21,012.67	-1,013	105
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	120,000	23,640	-96,360	24,193.50	-554	102
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	26,818,130	29,690,471	2,872,341	29,493,996.32	196,475	99

Planifikimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 26.8 miliardë lekë, ku **peshën më të lartë të shpenzimeve (96%) e zë transferata buxhetore ndaj të tretave** në masën **25.75 miliardë lekë**. Transferata e alokuar në këtë program është planifikuar për të përballuar shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë dhe shpërblimin e lindjes. Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në këtë zë, duke u rritur me 3 miliardë lekë, rezultat i rishikimit të masës së ndihmës ekonomike dhe paaftësisë nga paketat e rezistencës sociale të ndërmarra nga Qeveria për të zbutur efektet e luftës Rusi - Ukrainë në ekonominë shqiptare. Për pjesën e shpenzimeve korrent, performanca e programit në terma financiare **rezulton e lartë me gati 99%** realizim krahasuar me planin e rishikuar.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale të programit ka qenë në masën 120 milionë lekë, nga të cilat 20 milionë planifikohen si financim i brendshëm dhe 100 milionë lekë si financim i huaj. Planifikimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj rezultojnë jo i qëndrueshëm, duke rezultuar në devijanca nga plani fillestar i projekteve, me gati 80% të vlerës fillestare të planifikuar për t'u realizuar. Pavarësisht kësaj, fondi financiar i mbetur pas rishikimeve të planit për këtë zë është realizuar 100%.

Programi paraqitet i qëndrueshëm në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre të lidhura me shpenzimet korrent. Produktet e programit janë të qëndrueshme, që do të thotë janë në përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i

politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore. **Ndërkohë,** nuk mund të themi të njëjtën gjë për **produktet/projektet e investimeve publike të cilat rezultojnë në një planifikim jo të qëndrueshëm buxhetor.**

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Në 000/lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia Fillestar	Plani fillestar	Sasia e rishikuar	Plani I rishikaur	Sasia Faktike	Shpenzime faktike
91307AA	Familje dhe individë ne nevojë që përfitojnë nga skema e NE	67,000	6,240,000	67,000	6,713,236	62,688	6,664,731
91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	167,000	16,990,000	167,000	18,535,928	161,683	18,436,231
91307AC	Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat	450	272,180	450	278,389	210	274,522
91307AD	Bonusi i Bebeve	35,000	2,200,000	35,000	3,100,000	42,504	3,100,000
91307AE	Raporte monitorimi për mbrojtjen e fëmijeve	1	10,470	1	10,205	1	10,079
91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	200	120,000	200	0		0
91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësisve	35	200,000	35	195,368	35	158,818
91307AJ	Fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit	230	253,060	230	240,785	200	237,503
91307AK	Te moshuar te trajtuar ne sherbime te perkujdesit	350	202,990	350	185,540	310	184,893
91307AL	Vendime gjyqesore per PAK te ekzekutuara	0	0	0	199,895		196,897
91307AM	Persona me aftesi te kufizuara qe perfitojne sherbime te perkujdesit	197	209,430	197	207,485	198	206,129
18BC201	Modernizimi i Asistences Sociale nga BB	1	100,000	1	20,000		21,013
18BC205	TVSH e asistences teknike per projektin "Perfshirja sociale" IPA II	0	0	0	440		341
18CC006	TVSH per rikonstruksion te Qendres Sociale ne Linze	1	7,800	1	0		0
18CC007	TVSH per projektet e rikonstruksionit te qendres per femije me aftesi te	2	12,200	2	3,200		2,840

- Kanë përfituar nga skema e ndihmës ekonomike **62 688 familje** nga **67 000 të planifikuar me buxhetin fillestar për vitin 2022**. Janë shpenzuar 6.66 miliardë lekë nga 6.7 miliardë lekë të planifikuar me buxhetin e rishikuar.
- Kanë përfituar nga **pagesa sociale 161 683 PAK dhe Kujdestarë** nga **167 000 të planifikuar**. Janë shpenzuar **18.4 miliardë lekë nga 18.5 miliardë të planifikuar**.
- **Kanë përfituar 210 Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike**, nga 450 të planifikuar me buxhetin fillestar. Janë shpenzuar 274.5 milionë lekë nga 278 milionë të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Ajo që konstatohet është planifikimi i dobët fillestar i bërë për këtë produkt, sipas të cilit planifikoheshin të

përfitonin shërbime 450 përfitues, duke vënë në diskutim dhe kosto për njësi të planifikuara të këtij shërbimi.

- Kanë përfitur **bonus për lindje 42 504 nëna** nga 35 000 të planifikuara me buxhetin fillestar. Janë shpenzuar **3.1 miliardë lekë** nga 2.2 miliardë të planifikuara me buxhetin fillestar për vitin 2022.
- Ka zhvilluar aktivitetin e saj normal **Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve** duke shpenzuar të gjithë buxhetin e dedikuar për të, me një fond total prej 10 milionë lekë nga 10.2 milionë të alokuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2022.
- Është planifikuar **fondi prej 120 milionë lekë dhe 200 përfitues nga grupet sociale të pafavorizuar për t'u punësuar në ndërmarrjet sociale**, por ky produkt është rishikuar gjatë vitit dhe për pasojë **nuk është realizuar**. Mungojnë argumentet në raportet zyrtare të publikuara nga MSHMS mbi anulimin e kësaj politike.
- Janë planifikuar **35 shërbimet të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nga njësitë vendore** me një fond prej 200 milionë lekë, produkt i cili rezultoi i realizuar në masën 100% në terma sasiorë dhe kohorë.
- Kanë përfitur **shërbim në qendrat e përkujdesit social 200 fëmijë** nga 230 të planifikuar me buxhetin fillestar 2022 dhe janë shpenzuar 237 milionë lekë, nga 240 milionë të alokuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2022.
- **310 të moshuar** janë trajtuar me shërbime në qendrat e përkujdesit social, nga **350 të planifikuar, duke shpenzuar 184.8 milionë lekë nga 185 milionë të planifikuar** me buxhetin e rishikuar.
- Kanë përfitur shërbime sociale në qendrat e përkujdesit **198 Persona me Aftësi të Kufizuar, nga 197 të planifikuar me buxhetin fillestar**. Janë shpenzuar 206 milionë lekë nga 207.4 milionë lekë të planifikuar me buxhetin e rishikuar.

Lidhur me performancën e produkteve të investimeve publike, vërejmë se rezultoi e ulët si për projektet me financim të huaj ashtu dhe ato me financim të brendshëm.

Konkretisht, projekti me financim të huaj **“Modernizimi i Asistencës Sociale nga Banka Botërore”** ishte planifikuar në masën 100 milionë lekë, por është rishikuar gjatë vitit në masën 20 milionë lekë, duke dëshmuar për një planifikim jo të qëndrueshëm buxhetor. Projektet e tjera me financim të brendshëm janë detyrime të palës shqiptare në formën e **TVSH për projekte rikonstruksioni Qendrash Sociale apo ajo e fëmijëve me aftësi të kufizuar** për të cilat mungon një informacion i detajuar në raportet e publikuara nga MSHMS mbi progresin dhe rezultatet e arritura konkrete nga këto projekte.

Programi “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë”

Integrimi i ish të Përndjekurve Politikë nga regjimi komunist në jetën e shoqërisë shqiptare. Pagesat e dëmshpërblimit të ish dënuarve politik.

Qëllimi i politikës së këtij programi është “Integrimi në jetën sociale të shoqërisë shqiptare e ish të Përndjekurve Politike nga regjimi komunist, si dhe dëmshpërblimi financiar për dëmet e shkaktuara”. Ky qëllim përmbushet përmes objektivave të mëposhtëm:

1. Ndjekja e çështjeve për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë nga regjimi komunist në jetën e shoqërisë shqiptare.
2. Pagesat e dëmshpërblimit të ish dënuarve politik.

Në 000/lekë

Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë		Plani Fillestar	Plani Vjetor i Rishikuar	Ndryshimi I planit vjetor	Shpenzime Faktike	Ndryshimi Plan i ishikuar Fakt	% e Realizimit
600	Paga	18,664	18,197	-467	17,757.19	440	98
601	Sigurime Shoqërore	3,117	3,039	-78	2,958.18	81	97
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,210	7,089	-4,121	6,630.80	458	94
603	Subvencione	0	0	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	3,000	3,000	2,975.00	25	99
605	Transferta Korente të Huaja	3,000	0	-3,000	0.00	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,000,000	1,000,430	430	996,919.98	3,510	100
Nëntotali Shpenzime Korente		1,035,991	1,031,755	-4,236	1,027,241.16	4,514	100
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		0	0	0	0.00	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0.00	0	0
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të hu		0	0	0	0.00	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale		0	0	0	0.00	0	0
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		1,035,991	1,031,755	-4,236	1,027,241.16	4,514	100

Planifikimi fillestar buxhetor në këtë program ka qenë në masën 1.035 miliardë lekë dhe është i gjithë për pjesën e shpenzimeve korrent, pasi për këtë program për vitin 2022 nuk janë planifikuar projekte investimi publike. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e ka transferata nga buxheti i shtetit për kompensimin e ish të përndjekurve politikë, e cila është planifikuar në masën 1 miliard lekë. Gjatë vitit 2022, **rishikimi i planit buxhetor** është bërë në masën më të madhe në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, duke u reduktuar me **4.1 milionë lekë**.

Programi paraqitet i qëndrueshëm në aspektin e planifikimit buxhetor të produkteve dhe realizimit të tyre të lidhura me shpenzimet korrent. Produktet e programit janë të qëndrueshme, që do të thotë janë përputhje me produktet e krijuara nga MSHMS në dokumentin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe gjatë vitit 2022 nuk janë prezantuar produkte të reja. Vijon zbatimi i politikave të nisura të programit dhe në vitet e mëparshme pa ndryshime thelbësore.

Më poshtë paraqitet performanca e produkteve të këtij programi në vlerë sasiore dhe në vlerë financiare (000/lekë) për vitin 2022:

Në 000/lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia Fillestar	Plani fillestar	Sasia e rishikuar	Plani i rishikuar	Sasia Faktike	Shpenzimet faktike
91302AA	Ish te Perndjekur Politik te rehabilituar dhe integruar	800	35,991	800	31,755	900	30,746
91302AB	Ish te perndjekur (dosje) te kompensuar financiarisht	7,300	1,000,000	7,300	1,000,000	6,162	996,495

Produkti “Ish të Përndjekur Politik të rehabilituar dhe integruar” është planifikuar në sasinë plan 800 persona dhe në fakt janë rehabilituar 900 të tillë. Janë shpenzuar 30.7 milionë lekë nga 31.75 të planifikuar me buxhetin e rishikuar. Vihet re një inkonsistencë në planifikimin e sasisë së produkteve plan dhe fakt e cila duhet saktësuar në raportet e monitorimit.

Për Produktin “Ish të përndjekur (dosje të kompensuar financiarisht)” janë planifikuar 7300 dosje për t’u trajtuar me fondin 1 miliard lekë dhe janë trajtuar faktikisht 6162 dosje me një fond prej 996,5 milionë lekë.

3. Treguesit e performancës në buxhetin e MSHMS për vitin 2022



Konkluzione

- **Të dhënat e publikuara** nga MSHMS dhe MFE mbi monitorimin e buxhetit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **rezultojnë të kufizuara**, duke vështirësuar analizën e performancës së shpenzimeve dhe produkteve të realizuara në këtë sektor gjatë vitit 2022.
- **Cilësia e raporteve të publikuara të monitorimit është e dobët**, duke u shoqëruar me një **mungesë të theksuar transparence në përdorimin e fondeve buxhetore**, veçanërisht ato të lidhura me projektet e investimeve publike.
- **Planifikimi i Buxhetit për këtë sektor rezulton i dobët** dhe me volatilitet të lartë, e cila dëshmohet nga devijancat buxhetore nga faza e planifikimit të buxhetit në atë të zbatimit. Mungesë koherence shfaq planifikimi i investimeve publike, duke detajuar projekte të ndryshme në fillim të vitit buxhetor e duke i rishikuar në mënyrë të herëpashershme gjatë vitit.
- **Probleme me kostimin e produkteve** janë të dukshme në politikat kryesore të sektorit, duke ngritur dyshime mbi përgjegjshmërinë manaxheriale të procesit të kostimit të shërbimeve shëndetësore.
- **Mungesë transparence e theksuar** shfaqet dhe tek monitorimi i shpenzimeve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ku nuk gjejmë në raportet e monitorimit të publikuar nga MSHMS asnjë analizë të lidhur me produktet e realizuara nga fondi. Mbajmë në konsideratë që fondi financohet jo vetëm përmes transfertës së buxhetit por dhe nga të ardhurat e krijuara nga sigurimi i kujdesit shëndetësor, për të cilat nuk paraqitet një analizë se si alokohen ato në produkte konkrete të programit.
- **Shëndetësia në Shqipëri vazhdon të mbetet e fundit në rajon** sa i përket shpenzimeve publike në raport me shpenzimeve e përgjithshme publike, gjë e cila vijon të mbetet në fuqi dhe për vitin 2022. Politikat shëndetësore dhe ato të mbrojtjes sociale mbeten të nën-financuara, duke bërë që shpenzimet publike të sektorit të realizohen të paprioritarizuara, pa vëmendjen e nevojshme të qeverisë në llogaridhënie mbi përdorimin e tyre duke riskuar kështu dhe keqpërdorimin e fondeve buxhetore.